

VENDIM
Nr. 935, datë 26.12.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 545, DATË 16.8.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE,
BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE E TË STUDENTËVE NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2012-2013”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1 e 5 të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 29 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 57 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 545, datë 16.8.2012 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për vitin e ri akademik 2012-2013, të japë 1 440 (një mijë e katërqind e dyzet) bursa për nxënësit dhe 2 050 (dy mijë e pesëdhjetë) bursa për studentët, për hyrjet e reja në vitin e parë në sistemin arsimor publik për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2 të vendimit.”.

2. Pika 14 ndryshohet si më poshtë vijon:

“14. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave, për të gjitha kategoritë e shkollave është data 31 janar 2013.”.

II. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, DAR/ZA-të, institucionet publike të arsimit të lartë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha